



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në çështjen gjyqësore të Pjetër Shalës, këtë pasdite filloi seanca e apelit dhe pritet të vazhdojë mëngjesin e nesërm.

Pjetër Shala u shpall fajtor nga Trupi Gjyqësor për krimet e luftës të ndalimit arbitrar dhe të vrasjes së paligjshme më 16 korrik 2024 dhe u dënua me 18 vjet burgim, duke llogaritur kohën e kaluar në paraburgim. Ai ka apeluar Aktgjykimin dhe dënimin, si edhe urdhrin që miraton zhdëmtimin e tetë viktimave pjesëmarrëse në këtë çështje gjyqësore.

Gjatë seancës së apelit të z. Shala sot dhe nesër, Mbrojtja pritet t'u paraqesë gjykatësve të Panelit të Apelit arsyet pse kundërshton vendimin e gjykatësve të Trupit Gjyqësor. Gjithashtu, Prokuroria dhe Mbrojtja e Viktimave kanë mundësi të paraqesin parashtrime me gojë.

Dhomat e Specializuara të Kosovës mbështesin të drejtat për gjykim të drejtë të garantuara sipas Kushtetutës së Kosovës dhe të drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Në qoftë se një i pandehur nuk pajtohet me vendimin e gjykatës, ai mund ta apelojë atë. Një panel krejt i ri me gjykatës të tjerë të Dhomave të Specializuara rishqyrton çështjen në mënyrë të pavarur. Paneli i Gjykatës së Apelit mund ta lërë në fuqi, prapësojë ose ndryshojë Aktgjykimin e Trupit Gjyqësor. Të pandehurit në Dhomat e Specializuara deri më tani kanë përdorur rregullisht këtë të drejtë. Ky sistem i fuqishëm i kontrolleve dhe balancave garanton realizimin e drejtë dhe të paanshëm të drejtësisë.

Në gjykimin e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, më 13 maj Trupi Gjyqësor vendosi, mbi një kërkesë të Prokurorisë, të pranonte si prova një grup dokumentesh të Zonës Operative të Dukagjinit. Trupi Gjyqësor refuzoi disa nga dokumentet e propozuara dhe pranoi disa të tjera, duke zbatuar standardin ligjor të përcaktuar në Rregulloren e DHSK-së, sipas të cilit gjykatësit duhet t'i pranojnë provat në qoftë se kanë lidhje me lëndën, janë autentike dhe në qoftë se vlera provuese e tyre nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre.

Përkujtesë, Prokuroria në këtë çështje përfundoi thirrjen e dëshmitarëve dhe paraqitjen e provave të veta në prill 2025 dhe pas kësaj ekipet e Mbrojtjes njoftuan Trupi Gjyqësor për synimin e tyre për të paraqitur mocione për rrëzimin e disa ose të gjitha akuzave në Aktakuzë.





Kryetarja e Dhomave të Specializuara të Kosovës Ekaterina Trendafilova vizitoi Kosovën këtë javë në kuadër të aktiviteteve të Programit për komunikim dhe ndërgjegjësim dhe u takua me palët e interesuara për punën e DHSK-së. Gjatë vizitës së saj treditore, ajo u takua me studentë të drejtësisë me të cilët diskutoi kornizën ligjore të DHSK-së, mandatin dhe funksionimin e tyre. Ajo gjithashtu vizitoi Qendrën e Dokumentimit të Fondit për të Drejtë Humanitarë Kosovë.

Në përputhje me angazhimin e DHSK-së për transparencë, Kryetarja e DHSK-së kishte planifikuar dhe një konferencë për shtyp me gazetarët për t'iu përgjigjur pyetjeve të tyre, por ajo nuk u zhvillua për shkak të protestave të veteranëve të luftës dhe të tjerëve që përdorën bomba tymuese.

DHSK-ja mbetet e angazhuar për informimin në mënyrë transparente të publikut dhe gazetarëve në Kosovë në lidhje me ecurinë e proceseve gjyqësore në Hagë.

